



03-4653/12/01
Sud



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE
U PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr. 498/05/2012

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE PRIZREN-me Gjyqtarin Gani Kastrati me procesmbajtësen Mire Beqiraj , ne proceduren kundervajtëse kunder te pandehures: Ajshe Musa Shala nga Prizreni rruga „ Leka I Madh”, nr. 12 , përshkak të kundervajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3, si dhe nenit 9, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1.3, të Ligjit nr. 04/L-050, për Deklarimin , Preardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë public dhe deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, e ne baze të nenit 195 , të LMK-se me dt. 19.12.2012 mori këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Ajshe Musa Shala , e lindur me 1958, nga Prizreni rruga „ Leka I Madh”, nr. 12, Kombësia, Shqipëtare , Kosovare, me profesion mësuese, ka të kryer Shkollen e lartë , e martuar nënë e tre fëmijëve , e gjendjes së mirë ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse e pandehura si zyrtarë I lartë public-këshilltare e KK Prizren, nuk e ka bërë në afatin e rregulltë ligjor , deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë së Antikorrupsionit në Prishtinë, gjegjësishtë nuk e ka përmbushur obligimin e saj ligjor për deklarimin e pasurisë brenda afatit ligjor sipas kërkesës së Agjencisë.

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 5,6 paragrafi 1.3, si dhe nenit 9, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1.3, të Ligjit nr. 04/L-050, për Deklarimin , Preardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë public dhe deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Mirëpo gjykata duke aplikuar nenin 9, të LMK-së, ja zbuti denimin nën masën minimale të përcaktuar për atë lloj të kundervajtjes , mu për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumën prej 300 euro (Treqindë) euro.

I pandehuri është i obliguar që gjobën e shqiptuar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishëmiris se aktvendimit. Poqese I pandehuri nuk e paguan gjobën brenda afatit të caktuar e njejtja do të zevendsohet me denim me burgë , duke llogaritur 15, për një ditë burgu , dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në afat të njejtë obligohet të paguaj 5 euro .

A r s y e t i m

Me kërkesën Agjencisë kunder Korrupsionit për deklarimin e pasurisë në Prishtinë , me nr. 01-1913/2012, të dt. 24.05.2012, është ngritur procedura kundervajtëse kunder të pandehurit: Ajshe Musa Shala nga Prizreni, për shkak të kundervajtjes si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

Gjykata me qellim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka ndëgjuar dhe marrur në pyetje të pandehurin në seancën verbale të mbajtur me dt. 10.07.2012, e cila në mbrojtjen e saj kundervajtjen për të cilën është e ngarkuar e ka pranuar, por me një përjashtim të veçantë thekson faktin se pa fajin e saj ka ardhur deri tek vonesa për deklarimin e pasurisë, ngase e pandehura në deklaratën e saj e pohon faktin se nuk ka qenë e njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregulltë nga pika kontaktuese lidhur me pranimin e formularëve për deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë së kunder korrupsionit në Prishtinë, si dhe nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga ndonjë organ kompetent lidhur me formularë për deklarimin e pasurisë , duke shtuar se për këtë qështje lidhur me deklarimin e formularëve për deklarim të pasurisë është njoftuar për të paren herë në seancën gjyqësore e jo edhe në pikën kontaktuese pranë KK Prizren, ku e njejtja ushtron funksionin si këshilltare. Mirëpo në nderkohë pas përfundimit të seancës gjyqësore I ka prezentuar Gjykatës vërtetimin nga Agjencia Kunder korrupsionit në Prishtinë të dt. 11.07.2012, me nr. 03/3551/2012, me të cilën deshmohet se e pandehura Ajshe Shala me vones ka bërë dorëzimin e formularëve për deklarimin e preardhjes dhe gjendjes së pasurisë , conform nenit 9, të Ligjit të sipërshtuar, kun jë kopje e vërtetimit mbetet në shkresat e lëndës si provë materjale.

Gjykata poashtu në cilësi të deshmitarit ka ndëgjuar dhe marrur në pyetje në seancën verbale të mbajtur me dt. 20.07.2012, Samir Hoxhen, i cili në deshmin e tij ka përshkruar në tërësi rastin duke dhënë detajet përkitazi me njoftimin me kohë dhe në mënyrë të rregulltë të gjithë zyrtarët e lartë public –këshilltarët komunal, dhe drejtorët e drejtorive , pasi që I njejtë gjatë asaj kohe ishte shef i protokollit në kabinetin e kryetarit në KK Prizren, i cili pohon se me kohë dhe në mënyrë të rregulltë ka qenë i njoftuar me shkresë zyrtare , nga agjensia kundër korrupsionit në Prishtinë , për njoftimin dhe dërgimin e formularëve për deklarimin e rregulltë vjetor të pasurisë për të gjithë zyrtarët e lartë public, emrat të cilëve janë të bashkangjitur në kërkesë dhe në shkresat e lëndës , pas të cilit veprim thekson Samir Hoxha, se zyrtarishtë I ka njoftuar me shkrim e poashtu edhe përmes imelit zyrtarë me të cilin imel përfshihet edhe Këshilltarja e KK Prizrenit, Ajshe Shala si zyrtarë I lartë public- këshilltare, e cila poashtu ka qenë i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregulltë, e poashtu njoftimin e ka bërë edhe përmes mbledhjeve të bordit të drejtorëve, si dhe të njejtit janë njoftuar edhe përmes Kryetarit të KK Prizrenit, për të cilin veprim është njoftuar edhe Këshilltarja e KK Prizrenit , Ajshe Shala , lidhur me afatin e rregulltë ligjor për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë public, duke u dërguar kopje të formularëve , ndaj thekson Samir Hoxha tani Drejtor për Turizem, se sa I përket punës së tij zyrtare lidhur me njoftimin dhe shpërndarjen e formularëve të pasurisë, ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë e ka bërë me kohë dhe në mënyrë të rregulltë . Për ta vërtetuar këtë faktë I njejtë I prezantoi Gjykatës në shikim origjinalin e imelit zyrtarë të dt. 15.02.2012, ora 13.01, min, dhe një kopje e origjinalit mbetet në shkresat e lëndës si provë materiale me të cilin vërtetohet se të gjithë zyrtarët e lartë public, lista të cilëve është në shkresat e lëndës janë njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregulltë . Poashtu për këtë çështje e ka njoftuar edhe Komitetin për politik dhe financa dhe të gjithë shefat e grupeve parlamentare , pranë KK Prizrenit, të cilët kanë marrë për obligim që këtë informatë ta përcjellin tek këshilltarët grupeve parlamentare thekson zyrtari ligjor Samir Hoxha, i cili gjatë asaj kohe ishte i caktuar në këtë pikë kontaktuese si shef i protokollit , duke përfunduar se të gjithë zyrtarët e lartë public janë njoftuar edhe në seancë të rregulltë në Asamble Komunale në KK Prizren.

Edhe deshmitari – shefi i shërbimit profesional në KK Prizren, Ibrahim Krasniqi në deklaratën e tij deshmon se e pandehura me kohë dhe në mënyrë të rregulltë është njoftuar sikurse të gjithë anëtarët e KK Prizrenit, me formularët për deklarimin e pasurisë dhe për obligimin e tyre ligjor, sipas afatit kohor.

Poashtu Gjykata ka ndëgjuar dhe marrur në pyetje edhe parashtrusën e kërkesës Enis Sadikun –zyrtarë I lartë I Antikorrupsionit në Prishtinë, në seancën verbale të mbajtur me dt. 02.11.2012, i cili në deklaratën e tij përveq se ka ngelur në tërësi pranë shënimeve të cekura në kërkesë lidhur me kundërvajtjen për të cilën është I ngarkuar I pandehuri për mos deklarim të rregulltë vjetor të pasurisë, thekson edhe atë se I pandehuri është njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregulltë për obligimin e tij ligjor – për deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së agjensis , duke pohuar dhe arsyetuar faktin se e pandehura me dt. 11.07.2012, I ka sjellur formularët e plotësuar për deklarimin e pasurisë në agjensinë kundër korrupsionit në Prishtinë por me vonë, thekson parashtrusi I kërkesës në deklaratën e tij.

Gjykata pas administrimit të provave në shkresat e lëndës, deklaratës së të pandehurës , deklaratës së deshmitarëve , kërkesës së organit –Agjensisë kundër Korrupsionit në Prishtinë, bëri shikimin dhe leximin në deshmit e bashkangjitur në kërkesë dhe atë në njotimin e dërguar nga AKK-pikave kontaktuese në institucionet përkatëse , të dt. 01.03.2012, me nr. 03-767/2012, listën e zyrtarëve të lartë të pranuar nga institucioni ku punon zyrtari në fjalë, njoftimin lidhur me procedurën dhe afatin e deklarimit e gjendjes së pasurisë, të dt. 01.03.2012, me nr. 01-750/2012, dhe provave tjera në shkresat e lëndës Gjykata ka konstatuar dhe vërtetuar ekzistimin e kundërvajtjes bërë nga ana e të pandehurës, ndaj edhe për këtë e ka shpallur përgjegjës dhe I është shqiptuar dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi , dhe me rastin e caktimit të dënimit janë vlersuar rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja , pesha e veprës kundërvajtëse dhe shkalla e përgjegjësisë së të pandehurës, sjellja e saj korrekte në gjykatë, prezentimit të vërtetimit, është kundërvajtja e parë dhe e pa qellimtë Gjykata e muar si rrethan lehtësuese , prandaj duke pasur parasysh rrethanat nga neni 7 –të LMK-së dhe duke aplikuar nenin 9, të LMK-së, të pandehurit ja zbuti dënimin nën masën minimale të përcaktuar për atë lloj veprës kundërvajtje duke I shqiptuar dënimin me gjobë, me bindje se edhe me këtë do të arrihet qellimi i dënimit në përputhje me parimeve tek e pandehura dhe të tjerët .

Shpenzimet e procedurës janë të caktuara në bazë të nenit 99 art.2 të Ligjit mb kundërvajtje.

Në bazë të atyre u cek u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN

Nr. 498/05/2012

Procesmbajtësja

Mire Beqiraj

Gjykatari
Gani Kastrioti

UDHEZIMI JURIDIK: Kunder këtij aktvendimi në afat prej 8 ditësh nga dorezimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.